



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 311/7 prot.

Tiranë, më 28.2. 2020

**RELACION**

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2019

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, në vijim paraqitet një analizë e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2019, për Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	65,830	72,762	68,163	93.7%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,356	90.4%
<b>TOTALI</b>	<b>67,330</b>	<b>74,262</b>	<b>69,519</b>	<b>93.6%</b>

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2019 në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale janë 67,330 mijë lekë. Në 4-mujorin e fundit të këtij viti është rishikuar buxheti nëpërmjet akordimit të fondit shtesë në “shpenzime personeli”, si dhe janë kryer rialokime të fondeve në shpenzime korente. Buxheti i rishikuar për Institucionin e Komisionerëve Publikë arriti në nivelin 74,262 mijë lekë.


Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2019 është në nivelin 93.6 % ose 1% më e lartë se në vitin 2018, në të cilin realizimi i fondeve ka qenë në nivelin 92.6% dhe kryesisht kjo rritje vërehet në realizimin e shpenzimeve kapitale.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për vitin 2019, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	56,100	66,100	64,459	98 %
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi veçantë	9,730	6,662	3,703	56 %
231	Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,356	90.4 %
	<b>TOTALI</b>	67,330	74,262	69,518	93.6 %



**1. Artikulli 600 dhe 601, "Shpenzime personeli",** buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2019 për këtë zë ishte 56,100 mijë lekë, buxhet i cili nuk mbulonte nevojat e institucionit për të gjithë vitin, parashikuar kjo dhe gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin 2019. Në komunikimet tona me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjatë periudhës nëntor 2018 - maj 2019, për të cilat janë vënë në dijeni edhe Kuvendi, Kryeministria dhe ONM-ja, kemi parashtruar në mënyrë të përsëritur shqetësimin lidhur me fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, duke shprehur gatishmërinë për çdo komunikim të nevojshëm, dhe shpjeguar në

mënyrë të përsëritur të gjitha elementet e pagave dhe shtesave mbi to, në bazën e të cilave është përlllogaritur buxheti i kërkuar nga institucioni.

Me gjithë komunikimet e vazhdueshme institucionale, pamjaftueshmëria e fondit të pagave ka krijuar problematika në pagesat e punonjësve të Institucionit të Komisionerëve Publikë për muajt nëntor dhe dhjetor 2019.

Buxheti i akorduar në shpenzime personeli u rishikua me VKM-në nr. 730, datë 13.11.2019, duke miratuar një fond shtesë në shpenzime korente për institucionet e rivlerësimit, si dhe me transferimin e fondeve brenda shpenzimeve korente, ky buxhet arriti në vlerën 66,100 mijë lekë, duke mbuluar kështu nevojat për periudhën nëntor - dhjetor 2019.

Buxheti i vitit 2019 është akorduar për 30 punonjësit e institucionit, strukturë e miratuar në Vendimin e Kuvendit nr.102/2018, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”.

**2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”,** buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2019 ishte 9,000 mijë lekë dhe pas rialokimit të fondeve me kërkesën e institucionit, nëpërmjet transferimit në fondin e pagave për shkak të pamjaftueshmërisë së tij, arriti në 6,000 mijë lekë. Performanca e realizimit të buxhetit të artikullit “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, për vitin 2019 është në nivelin 56%. Vlen të theksohet që në këtë nivel të realizimit të buxhetit ka ndikuar fakti që nevojat për mallra dhe shërbime kryesore për aktivitetin e institucionit janë plotësuar dhe furnizimi materialo-teknik është kryer në fund të vitit 2018, për shkak të historikut të institucionit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, kryesisht në tremujorin e fundit të vitit 2018. Kjo ka sjellë që shumë materiale të nevojshme për aktivitetin e institucionit të ishin gjendje në magazinë dhe të përdorëshin gjatë vitit 2019, si: letër, tonera, karburant për automjetin dhe gjeneratorin etj. Për këtë arsye, procedurat e prokurimit për blerjen e këtyre materialeve nuk janë zhvilluar. Në mënyrë analitike, zërat e shpenzimeve janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	2,120	987
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	1,645	1,538
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	1,215	857
4	Shpenzime mirëmbajtjeje të zakonshme	360	120
5	Shpenzime të tjera speciale	660	143
	<b>T O T A L I</b>	<b>6,000</b>	<b>3,645</b>

Gjatë vitit 2019 janë kryer disa procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël për shpenzime materialesh zyre dhe të përgjithshme, kryesisht kancelari dhe materiale pastrimi, si dhe me procedura të thjeshtuara janë kryer blerje materialesh dhe shërbime speciale, si: ujë i pijshëm për punonjësit, dokumentacion specifik, botime zyrtare, karburant, siguracioni i automjetit,



mirëmbajtje etj. Janë lidhur kontratat dhe kryer shpenzime për shërbimin e parkimit, telefoninë celulare, abonimet në shtypin e ditës etj. Gjithashtu janë likuiduar në afat të gjitha detyrimet për furnizimin me energji, ujë, shërbim postar etj.

Mosrealizimi i fondeve, siç vihet re, është kryesisht në zërin materiale dhe shpenzime zyre, që lidhet me reduktimin e shpenzimeve për letër, tonera dhe karburant, për shkak të arsyeve objektive që u përmendën më lart, si dhe në zërat: shpenzime transporti, dieta administrative, mirëmbajtje automjeti dhe shërbime speciale.

**3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”,** buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2019 është 1,500 mijë lekë. Gjatë vitit nuk ka pasur rishikime të tij, duke plotësuar kështu nevojat e institucionit në pajisje kompjuterike dhe mobilie.


Performanca e realizimit të buxhetit të artikullit “Shpenzime kapitale”, për vitin 2019, është në nivelin 90%, të cilin e konsiderojmë një nivel të kënaqshëm, pasi diferencat plan - fakt vijnë si rezultat i diferencave ndërmjet buxhetit të prokuruar dhe atij të kontraktuar.

Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2019, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në formë tabelare dhe grafike, me shpjegimet përkatëse për çdo projekt investimi.

Në mijë lekë

Investimet	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në%
Blerje pajisje elektronike	850	850	838	99%
Blerje pajisje dhe mobilie zyre	650	650	518	80%
<b>TOTALI</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,356</b>	<b>90.4%</b>

### REALIZIMI I INVESTIMEVE 2019




**Grafiku - Realizimi i investimeve 2019 sipas projekteve (në mijë lekë)**

Gjatë vitit 2019 u realizuan procedurat e prokurimit për pajisje kompjuterike dhe pajisje - mobilie, laptopë, për Komisionerët Publikë dhe Njësinë ligjore, grirëse dokumentesh me kapacitet të lartë, si dhe kasaforta dhe karrige, duke plotësuar kështu nevojat shtesë të stafit. Gjithashtu, në muajin dhjetor, u finalizua dhe procedura e blerjes së *Firewall*-it, pajisje bazë për sigurinë në rrjet, e cila bllokoi ndërhyrjet apo sulmet e ndryshme që mund të vijnë nga jashtë, si dhe reflekton ndryshimet teknologjike apo përditësimet e kohës që ndodhin në fushën informatike.

Theksojmë se buxheti i vitit 2019 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore, duke respektuar afatet në kryerjen e shpenzimeve, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të shpenzimeve dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2019, duke zbatuar parimin e eficiencës, efikasitetit dhe ekonomicitetit.

**Nëpunës Zbatues**

Adelina Kastrati



**Nëpunës Autorizues**

Alketa Çeli



**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike					Kodi i Grupit		63		
Programet		Shpenzimet e Institucionit									
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2018	(2) PBA Viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 8 muajore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca			
0001	Programi 03360	46,423	77,931	67,330	74,262	74,262	69,518	-4,744			
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		46,423,00	77,931	67,330,0	74,262,0	74,262,0	69,518,0	-4,744,0			
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit											
Totali		46,423	77,931	67,330	74,262	74,262	69,518	-4,744			



Nepunesi Zbatues		Emri		Kordinatori i	
		Adelina Kastrati		GMS/Nepunesi	Alketa Çeli
				Autorizues	
	Emri			Emri	
	Firma			Firma	
	Data	28.2.2020		Data	28.2.2020



**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	Komisionerët Publikë Veprimtaria e Komisionerit Publik							Kodi i Grupit Kodi i Programit	63 03360 (7)=(6)-(5) Diferenca
	Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2018	(2) PBA Viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar viti korrent 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes12 muajore /progressiv		
600	Paga	34,940	60,991	50,600	59,900	59,900	58,540	-1,360	
601	Sigurime Shoqërore	2,950	5,940	5,500	6,200	6,200	5,920	-280	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,437	9,500	9,000	6,000	6,000	3,643	-2,357	
603	Subvencione							0	
604	Transferta Korente të Brendshme							0	
605	Transferta Korente të Huaja						0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			730	662	662	60	-602	
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>42,027</b>	<b>76,431</b>	<b>65,830</b>	<b>72,762</b>	<b>72,762</b>	<b>66,163</b>	<b>-4,599</b>	
230	Kapitale të Patrupëzuara	120						0	
231	Kapitale të Trupëzuara	4,276	1,500	1,500	1,500	1,500	1,356	-144	
232	Transferta Kapitale							0	
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim të brendshem</b>	<b>4,396</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,356</b>	<b>-144</b>	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0	
232	Transferta Kapitale							0	
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>4,396</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>1,356</b>	<b>-144</b>	
	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>						<b>0</b>		
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>46,423</b>	<b>77,931</b>	<b>67,330</b>	<b>74,262</b>	<b>74,262</b>	<b>69,519</b>	<b>-4,743</b>	


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	28.2.2020		Data	28.2.2020

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Komisionet Publike	83
Programi	Vepimetaria e Komisionit Publik	3380

Kodi	ne 000/leke	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	I			II			III			IV			Luhajtet ne Koston per Njesi			Komente		
				Sipenzim sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sasia Fakte (sipas vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sipenzimet (sipas planit te v. vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sipenzimet (sipas planit te v. vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sipenzimet (sipas planit te v. vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sipenzimet (sipas planit te v. vitit 2019)	Sasia Fakte sh. v. vitit (sipas vitit 2019)	Sipenzimet (sipas planit te v. vitit 2019)	V = IV - I		V = IV - II	V = IV - III
Produkti 1		Numer Ceshitresh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisionet Publike brenda afateve ligjore	nr. Ceshitresh	77	42,027	546	120	65,830	72,762	606	128	68,162	533	606	128	68,162	533	-2%	-3%	-12%	
Produkti 2		Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sate pjese	36	4,396	122	11	1,500	1,500	136	10	1,366	136	136	10	1,366	136	11%	-1%	-1%	
Totali				46,423	46,423	668	131	67,330	74,262	743	138	69,518	668	743	138	69,518	668				



Nepunesi Zbatues	Emri	Adeling Kastrali
	Firma	
	Data	28.2.2020

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Celi
	Firma	
	Data	28.2.2020



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave se programit"  
 Periudha e Raportimit: 12 mujori 2019



Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit: Veprimtaria e komisionerit Publik	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2018	Niveli i planifikuar ne vitin 2019	Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2019	Niveli faktik per 12 mujorin e vitit 2019	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	Komente
Qellimi 1									
	*Objektivat e politikës*:								
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te r'vleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullit ligjor, transparences dhe fyrmes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera. "	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2018	Niveli i planifikuar ne vitin 2019	Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2019	Niveli faktik per 12 mujorin e vitit 2019	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
	Numer Cesthlesh te njoftuara nga KPK te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda ateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	77	120	120	128	107%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Emri	Alketa Çeli
	Firma		Firma	
	Data	28.2.2020	Data	28.2.2020
		Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus		

**ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	Realizimi Progressiv fillimi i vitit 2019	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	650	2019	2019	518	650	518	518	518	Jane zhvilluar pothuajse te gjitha procedurat e planifikuar teprokurimit per pajisje e mobilje pervec pajisjeve te ndryshme pasi u rivleresuan nevojat.
M630013	Pajisje kompjuterike	850			838	850	838	838	838	Diferencat vjete mads buxhetit te kontraktuar dhe atij te prokuruar
<b>TOTALI</b>		<b>1,500</b>			<b>1,356</b>	<b>1,500</b>	<b>1,356</b>	<b>1,356</b>	<b>1,356</b>	-

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrioti	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues
	Firma		
	Data	28.2.2020	
	Emri	Alketa Çeli	
	Firma		
	Data	28.2.2020	